

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-209/14

Prishtinë,

1 Shkurt 2017

Në çështjen juridike të:

Ndërmarrja “K.” Prizren

Përfaqësuar nga Drejtori F.Q.

Prizren

Pala ankuese

Kundër

P.J.

Rruga “Tase Živančevića” nr.27/A

Beograd

Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, si kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/229/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13297), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 1 Shkurt 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e pasafatshme ankesa e F.Q. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/229/2014, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13297.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 22 gusht 2008, P.J. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) ku kërkon ri-posedimin e banesës me sipërfaqe prej 70 m², që gjendet në rrugën “Otobarske Revolucije” Lamela 2C/10, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë ka theksuar se ai është pronar i pronës së kërkuar dhe se posedimi mbi të njëjtën pronë ishte humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/99, ku përmend datën 13 qershor 1999 si datën e humbjes së posedimit.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë ka prezantuar dokumentet vijuese:
 - Pagesat e datave 7 mars 1994, 15 prill 1994, 10 maj 1994, 6 korrik 1994 dhe 24 gusht 1994. Nuk jepen detaje lidhur me pagesat, përveç, fjalisë së dhënë: *“Pagesa në bazë të kontratës së shitblerjes”* dhe shuma e parave që është paguar.
 - Vendimin mbi ndarjen e banesës nr. 521 të lëshuar nga Ndërmarrja “Prizren Prevoz” më 2 tetor 1995. Sipas këtij vendimi, palës përgjegjëse në ankesë i ishte ndarë prona e kërkuar në shfrytëzim të përhershëm. Në pikën 1 të vendimit ishte qartësuar se pala përgjegjëse në ankesë ishte bashkëpronar me sipërfaqen prej 14.058 m² në pronën e kërkuar.
 - Faturat e shërbimeve komunale të viteve 1997 dhe 1998 që dëshmojnë se pala përgjegjëse në ankesë e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar.
 - Kontratën mbi shitblerjen e banesës nr. 40/2001, të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes “Prizren Prevoz”, të përfaqësuar nga drejtori i saj Z.S. në cilësinë e shitësit dhe palës përgjegjëse në ankesë në cilësinë e blerësit. Kontrata mbi shitblerjen ishte vërtetuar në Gjykatën Paralele të Prizrenit më 4 tetor 2001.
 - Autorizimin nr. 118522/2010, të vërtetuar në Gjykatën e Parë Themelore të Beogradit më 13 shtator 2010. Pala përgjegjëse në ankesë e kishte autorizuar S.P. që ta përfaqësoj atë para AKP-së dhe para të gjitha institucioneve relevante në lidhje me pronën e kërkuar.

3. AKP-ja kishte bërë njoftimin e kërkesës sipas procedurës standarde duke e vendosur një njoftim në pronë më 17 korrik 2008. Ishte konstatuar se prona e kërkuar ishte e uzurpuar nga një person i panjohur. Më 5 dhjetor 2013, F.Q. , drejtor i Ndërmarrjes Urbane Transportuese “K.” kishte kërkuar të drejtën ligjore mbi pronën (në tekstin e mëtejme: pala ankuese)
4. Për të mbështetur pretendimet e tij, pala ankuese ka prezantuar dokumentet vijuese:
 - Kundërshtinë e Ndërmarrjes Transportuese Urbane NTU “K.” nr. 168, të paraqitur pranë Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së më 25 qershor 2009 përmes së cilës ai pretendon se Ndërmarrja “K.” është bartësja e vetme e së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë në asnjë moment nuk e kishte fituar të drejtën pronësore mbi të.
 - Përgjigjen nr. 213 të paraqitur më 6 shtator 2011 në të cilën pala ankuese ka deklaruar se pala përgjegjëse në ankesë kishte vetëm të Drejtën e Shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Sipas palës ankuese, që nga viti 1999 pala përgjegjëse në ankesë asnjëherë nuk ishte paraqitur në vendin e punës dhe si pasojë ai e kishte humbur të Drejtën e Shfrytëzimit mbi pronën e kërkuar ndërsa për sa i përket Kontratës së shitblerjes pala ankuese thekson se ajo ishte vërtetuar në një Gjykatë që është ilegale duke marrë parasysh vulën që tregon vitin 2001.
5. Vendimi i Ndarjes ishte verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ndërsa Kontrata e Shitblerjes, për shkak të legalizimit në Gjykatën Paralele të Komunës së Prizrenit, nuk ishte verifikuar.
6. Me vendimin e vet KPCC/D/R/229/2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) kishte miratuar të Drejtën e përhershme të Shfrytëzimit të palës përgjegjëse në ankesë.
7. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar S.B. më 13 qershor 2014. Ai kishte pranuar vendimin në emër të palës përgjegjëse në ankesë duke e dorëzuar Autorizimin Ov.Br. 5250/2012, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës, Dega në Graçanicë më 26 shtator 2012.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 9 qershor 2014. Djali i tij, T.Q. e kishte pranuar Vendimin e KKPK-së dhe si dëshmi se vendimi ishte pranuar ai kishte dorëzuar letërnjoftimin e palës ankuese. Më 12 gusht 2014, pala ankuese kishte paraqitur ankesë ndaj Vendimit të KKPK-së.
9. Ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 15 tetor 2014 ndërsa ai paraqiti përgjigje në ankesë më 28 tetor 2014.

Pretendimet e palëve

Pala ankuese

10. Pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së mbështetet mbi shkeljen e të drejtës materiale dhe procedurale dhe gjithashtu mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
11. Pala ankuese ka theksuar se pala përgjegjëse në ankesë i kishte dorëzuar Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së dokumentet e dyshimta që ishin siguruar gjatë kohës kur Ndërmarrja kishte qenë nën masa të dhunshme dhe secili vendim i lëshuar gjatë periudhës së masave të dhunshme nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm sepse rastet e ndarjes së banesave, përfshirë rastin aktual, janë vendosur në mënyrë arbitrare.
12. Sipas palës ankuese, pala përgjegjëse në ankesë nuk i ka përmbushur obligimet financiare ndaj Ndërmarrjes që i ka dhënë atij të drejtën e qiramarrjes.

Pala përgjegjëse në ankesë

13. Pala përgjegjëse në ankesë thekson se ai ka siguruar të Drejtën e Shfrytëzimit mbi pronën e kërkuar në mënyrë ligjore duke prezantuar në detaje dokumentet që janë dorëzuar nga ai në instancën e parë për të vërtetuar të drejtën e tij të shfrytëzimit.

Arsyetimi ligjor

14. Ankesa është e pasafatshme.
15. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh si në vijim: “*Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit lidhur me kërkesën, pala mund të dorëzojë ankesë kundër një vendimi të tillë nëpërmjet Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës*”.
16. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 9 qershor 2014. Kështu që afati kohor ka përfunduar më 8 korrik 2014 pasi që periudha 30 ditore ka përfunduar më 8 korrik 2014. Megjithatë, pala ankuese e kishte paraqitur ankesën e tij më 12 gusht 2014. Pra, kjo ishte bërë pas kalimit të afatit kohor.
17. Më 24 maj 2016 palës ankuese i ishte dorëzuar një urdhër gjykate. Ky urdhër gjykate thotë:

Nga F.Q. kërkohet që brenda dy javësh nga pranimi i këtij urdhri të:

- *Sqaroj marrëdhënien në mes të DP “Prizren Prevoz” dhe NTU “K.”*
- *Dorëzoj prova se ai ka të drejtë të përfaqësojë NTU K.. Në këtë kuptim F.Q. duhet të sqaroj, dhe ofroj prova, se çfarë entiteti juridik është NTU “K.”, si është i rregulluar përfaqësimi për këtë entitet juridik dhe në çfarë pozite F.Q. mund të përfaqësojë NTU “K.” në këtë ankesë si dhe të dorëzojë autorizimin e vërtetuar.*
- *Sipas fletë dërgesës, vendimi i KKPK-së, KPCC/D/R/229/2014 i datës 13 mars 2014, dhe vendimi i vërtetuar mbi kërkesën KPA13297 i datës 27 maj 2014, i ishin dorëzuar palës ankuese përmes T.Q. (djali i*

F.) më 9 qershor 2014, i cili i kishte dorëzuar AKP-së një kopje të letërnjoftimit të F.Q. t për atë dorëzim. Ankesa e palës ankuese është pranuar nga AKP-ja më 12 gusht 2014. F.Q. t i jepet mundësia që të sqaroj përse ankesa nuk është dorëzuar brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh nga data 9 qershor 2014.

18. Pala ankuese është përgjigjur në këtë urdhër të Gjykatës më 21 qershor 2016 duke bashkangjitur sqarimin në detaje në pyetjet e parashtruara nga gjykata. Lidhur me pyetjen se përse ankesa nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh pala ankuese përgjigjet se ai nuk ka pasur njohuri për mundësinë e paraqitjes së ankesës pasi që ai nuk ka marrë ndonjë njoftim për këtë çështje ligjore.

19. Gjykata Supreme e Kosovës nuk e pranon këtë arsyetim të palës ankuese për arsyet vijuese:

- Së pari, nga provat në dosjen e lëndës mund të shihet se kur djali i palës ankuese ka pranuar vendimin e KKPK-së, ai ka bashkangjitur letërnjoftimin e palës ankuese si dëshmi se vendimi është pranuar, pra pala ankuese ishte njoftuar për vendimin.
- Së dyti, faqja e fundit e vendimit të KKPK-së që ishte pranuar nga pala ankuese thotë:
“Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit lidhur me kërkesën, pala mund të dorëzoj ankesë kundër një vendimi të tillë nëpërmjet Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës?”.

20. Prandaj ankesa duhet të hidhet poshtë për arsye procedurale si e pasafatëshme në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 (a) dhe 196 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it